

INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT



BULETIN

2

Nëntor, 2012

Sami Kurteshi
AVOKATI I POPULLIT



Sami Kurteshi, është Avokati i Popullit, i pari vendor i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 4 qershor 2009, me mandat pesëvjeçar.

Sami Kurteshi, u lind më 5.6.1960 në Gjilan, Kosovë. Shkollimin fillor dhe të mesëm e kreu në vendlindje dhe studimet i vazhdoi në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Elektroteknikës, si dhe Gjuhë e Letërsi Angleze.

Për shkak të rrethanave politike në Kosovë, pas demonstratave të vitit 1981, pjesëmarrës aktiv i të cilave ishte, z. Kurteshi emigroi në botën e jashtme. Pas kthimit, për shkak të veprimtarisë së tij, nga pushteti i atëhershëm i Jugosllavisë u arrestua dhe iu shqiptua dënimi prej 9 vjetëve, të cilin e vuajti në burgjet e Beogradit dhe Pozharevcit në Serbi.

Pas lirimit nga burgu, në vitin 1991, z. Kurteshi u inkuadrua në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut - KMDLNJ në Prishtinë, si redaktor i publikimeve. Ndërsa gjatë viteve 1992-1995 ishte anëtar i Kryesisë së KMDLNJ-së dhe udhëheqës i Sekretariatit Qendror të KMDLNJ-së, ndërsa 1995-1996 ishte Sekretar i Përgjithshëm i KMDLNJ-së.

Nga viti 1992 deri 1996 ka qenë pjesëmarrjes i rregullt në sesionet e Komisionit dhe të Nënkomisionit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Gjenevë dhe bashkautor i disa rezolutave të Komisionit për Kosovën.

I ndjekur nga regjimi serb i asaj kohe, në fillim të vitit 1996 z. Kurteshi emigron në Zvicër. Në vitin 1998 fillon studimet në Universitetin e Bernit, Shkenca Politike, Sociologji, Ekonomi dhe të Drejtën Ndërkombëtare.

Nga vitet 2000-2001 studion në Shkenca Politike, Sociologji, dhe të Drejtën Ndërkombëtare në Universitetin e Cyrihut. Në vitin 1996 merr titullin e Magjistratit të Shkencave Politike (Master of Arts). Veprimtaria, pastaj edhe puna e tij vazhdon edhe nëpër institucione të rëndësishme shtetërore të Zvicrës, ku në vitet 1997-2001 ishte bashkëpunëtor profesional i Organizatës Zvicerane për Refugjatë (Schweizerische Flüchtlingshilfe SFH), si dhe bashkëpunëtor i televizionit shtetëror zviceran SF1. Në vitet 1999-2005 ishte bashkëpunëtor dhe udhëheqës i kurseve të ndryshme profesionale për bashkëpunëtorët e organizatave zvicerane për të drejtat e njeriut dhe për refugjatë: HEKS, SAH, SRK.

Gjatë qëndrimit të tij në Zvicër, z. Kurteshi u mor edhe me organizimin e komunitetit shqiptar në këtë shtet, duke themeluar shoqatat kulturore të mërgimtarëve shqiptarë në Zvicër (Cyrih, Siebnen, Basel, Bern, Bad Ragaz, Buchs).

Z. Kurteshi është autor, bashkautor dhe redaktor i disa publikimeve, analizave dhe raporteve të ndryshme. Ka përkthyer dy libra dhe ka publikuar në gjuhë të ndryshme (gjermanisht–shqip dhe anasjelltas).

Në periudhën 2003-2011 ka qenë docent privat në Qendrën Zvicerane për Edukimin e Personelit të Burgjeve në Zvicër (Schweizerische Ausbildungszentrum für das Strafvollzugspersonal – SAZ) në Friburg.

Z. Kurteshi flet disa gjuhë të huaja: anglisht, gjermanisht, serbokroatisht, ndërsa ka njohje elementare në gjuhën frënge dhe italisht.

Shqipe Ibraj – Mala
ZËVENDËSE E AVOKATIT TË POPULLIT



Shkollimi:

1995 Diplomoi në Fakultetin Juridik në Prishtinë,
2005 Kreu Provimin e Jurisprudencës,
2009 Regjistroi studimet pasdiplomike (drejtimi ndërkombëtar në Fakultetin Juridik në Prishtinë, në programin WUS Austria).
Ka marrë pjesë në shumë programe trajnimi për çështje të të drejtave të njeriut.

Përvoja:

1984 – 1986 Ndihmëse avokati privat në Pejë.
1999-2001 Përkthyes shqip - anglisht - shqip dhe zyrtare për Federatën Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, në bashkëpunim të ngushtë me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, në trajtimin e ish-të burgosurve, me program psikosocial.
2001 Praktikante në Prokurorinë Publike të Qarkut në Pejë (staf mbështetës për Prokurorin Ndërkombëtar).
2006 – 2011 Këshilltare ligjore në IAP.
2011 - Zëvendëse e Avokatit të Popullit në IAP, udhëheqëse në Departamentin e Ekzekutivit.

DEPARTAMENTI EKZEKUTIV

- **NJËSIA PËR HETIMIN E ANKESAVE KUNDËR PRESIDENCËS**
- **NJËSIA PËR HETIMIN E ANKESAVE KUNDËR QEVERISË DHE DIKASTERËVE TË SAJ**
- **NJËSIA PËR HETIMIN E ANKESAVE KUNDËR AGJENCIVE TË PAVARURA**
- **NJËSIA PËR HETIMIN E ANKESAVE KUNDËR NDËRMARRJEVE PUBLIKE**
- **NJËSIA PËR HETIMIN E ANKESAVE LIDHUR ME MJEDISIN**
- **MEKANIZMI NACIONAL PËR PARANDALIMIN E TORTURËS**

- Ky departament bashkëpunon me koordinatorët dhe zyrtarët për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore; me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione; me OJQ

- Gjatë ditëve të hapura që realizohen nga IAP nëpër komunat e Kosovës zëvendësavokati Bogolub Staletoviq mbulon komunat: Fushë Kosovë, Shtërpcë, Novobërdë, Graçanicë, Kllokot, Partesh dhe Ranillug.

Bogolub Staletoviq
ZËVENDËS I AVOKATIT TË POPULLIT



Shkollimi

1985 Diplomoi në Fakultetin Juridik, në degën Menaxhim dhe Planifikim, në Shkup.

Përvoja:

1978 - 1988 KNI "Ramiz Sadiku" në administrimin e çështjeve juridike.

1988 -1990 Zyra e vendit në Ferizaj, shef i zyrës, nga 1988 deri më 1990.

1990 - 1999 Elektrodistribucioni i Kosovës, udhëheqës i marketingut.

1999 – 2000 - FAO (Banka Botërore e Ushqimit) – Mbikëqyrës, zyrtar i lartë për të dhënat statistikore në gjithë Kosovën.

2000 – 2002 - Anëtar i komisionit për lutje dhe ankesa si dhe marrjes së vendimeve në KZAP (Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa).

2003 Udhëheqës i kontrollit - Inspektimi dhe revizioni i llogarive buxhetore, të financuar nga buxheti i MASHT-it, si dhe buxhetit të komunave për arsim si dhe buxhetit të shkollave.

2003 – 2011 Zëvendës i kryeshefit ekzekutiv, SKQZ (Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve).

2005-2006 dhe 2008-2009 Ushtrues detyre i kryeshefit ekzekutiv të SKQZ-së.

2011 – Anëtar i Komisioni për Regjistrimin e Popullsisë dhe - zyrtar për sensibilizim, zbatim të planit operativ dhe organizim të aktiviteteve të regjistrimit, përgatitja e doracakëve dhe të udhëzuesve të trajnimit.

2011 – Zëvendës i Avokatit të Popullit në IAP, udhëheqës në Departamentin kundër Diskriminimit.

DEPARTAMENTI KUNDËR DISKRIMINIMIT

- **NJËSIA PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE**
- **NJËSIA PËR BARAZINË GJINORE, KUNDËR TRAFIKIMIT DHE KUNDËR DHUNËS**
- **NJËSIA PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA**
- **NJËSIA PËR TË DREJTAT E KOMUNITETEVE**
- **NJËSIA PËR ÇËSHTJET SOCIALE**
- **NJËSIA PËR TË DREJTAT E PERSONAVE LGBT**

- Ky departament bashkëpunon me koordinatorët dhe zyrtarët për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore; me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione; me OJQ

- Gjatë ditëve të hapura që realizohen nga IAP nëpër komunat e Kosovës zëvendësavokati Bogolub Staletoviq mbulon komunat: Fushë Kosovë, Shtërpcë, Novobërdë, Graçanicë, Kllokot, Partesh dhe Ranillug.

Ibrahim Arslan
ZËVENDËS I AVOKATIT TË POPULLIT



Shkollimi

1982 Diplomoi në Institutin e Gazetarisë në Beograd.
1989 Diplomoi në Fakultetin Filozofik (Dega e Historisë) në Universitetin e Prishtinës.
2009 Përfundoi Shkollën për Integrim në BE.
2011 Është Ndërmjetësues i licencuar nga Ministria e Drejtësisë.
Ka marrë pjesë në shumë programe trajnimi për çështje të të drejtave të njeriut.

Përvoja

1975 - 1992 Gazetar i gazetës "TAN" në Prishtinë.
1984-1985 Zëvendësdrejtore dhe kryeredaktor në "TAN".
1988/89 Kryetar i Lidhjes së Gazetarëve të Kosovës.
1993-1995 Udhëheqës i OJQ-së për kulturë, art dhe sport "Gerçek", Prishtinë.
1998-1999 Zyrtar për hulumtimin e të shkeljeve të drejtave të njeriut, në Misionin Verifikues të OSBE-së në Kosovë.
Korrespondent për rajonin e Ballkanit i agjencisë së lajmeve IHA të Stambollit dhe agjencisë turke të lajmeve "Anadolu Ajansi" Ankara. Kohë pas kohë raportoi edhe për mediat të ndryshme botërore.
2003 Themelues dhe anëtar i Bordit të OJQ-së "YETED" NGO, për integrim dhe tolerancë.
2005 Anëtar i Këshillit të OJQ "Forumi 2015".
2006 Kryetar i Asociacionit të Gazetarëve të Mediave Turke, Prishtinë.
2009 Anëtar e Këshillit për Komunitete të Presidencës.
2011 Anëtar i Këshillit Mediave të Shkruara të Kosovës.
2011 Zëvendës i Avokatit të Popullit të Kosovës, udhëheq në Departamentin e Marrëdhënieve me Publikun.

DEPARTAMENTI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

- > **NJËSIA PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE**
- > **NJËSIA PËR BASHKËPUNIM ME ORGANIZATAT E HUAJA NË KOSOVË**
- > **NJËSIA PËR MATERIALE DHE PUBLIKIME**
- > **NJËSIA PËR BASHKËPUNIM ME DONATORË**
- > **NJËSIA PËR KONFERENCA DHE TRAJNIME**

- Ky departament bashkëpunon me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, me donatorët dhe fondacionet vendore dhe ndërkombëtare, po ashtu me mediat vendore dhe ndërkombëtare, si dhe me institucionet relevante në fushën e integritimeve evropiane.

- Gjatë ditëve të hapura që realizohen nga IAP nëpër komunat e Kosovës zëvendësavokati Ibrahim Arslan mbulon komunat: Prizren, Suharekë, Dragash, Mamushë, Malishevë, Rahovec dhe Shtime.

Isa Hasani
ZËVENDËS I AVOKATIT TË POPULLIT



Shkollimi:

1986 Diplomoi në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin Juridik, drejtimi i përgjithshëm.

2003 Kreu Provimin e Jurisprudencës në Departamenti i Administratës Gjyqësore, Ministria e Shërbimeve Publike në Prishtinë.

Që nga viti 1989 aktivist i KMLDNJ-së.

Ka ndjekur trajnime dhe seminare në fushën e hartimit të legjislacionit, mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të menaxhimit institucional

Përvoja:

1988 -1994 Jurist në ndërmarrje shoqërore dhe publike

2001-2005 Jurist rajonal në Projektin e Ndihmës Juridike Falas, të financuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim, në KMLDNJ

2005 Zyrtar Ligjor në Sekretarinë Koordinuese të Qeverisë, në Zyra e Kryeministrit.

2005 Koordinator i Tryezës Legjislative në Sekretarinë Koordinuese të Qeverisë –ZKM

2005 Përfaqësues i Qeverisë së Kosovës në Bordin për realizimin e Projektit për Rindërtimin e Kadastrit, në AKK

2006 Anëtar i përhershëm i Bordit të ankesave në ZKM.

2008 Zyrtar i Lartë Ligjor, në Sekretariatit e KGJK-së.

2009 Shef i Zyrës Ligjore, në Sekretariatit e KGJK-së.

2009 Jurist hetues në Departamentin e Hetimeve, në IAP.

2011 Zëvendës i Avokatit të Popullit, udhëheqës në Departamentit e Gjyqësorit.

DEPARTAMENTI I GJYQËSORIT

- > **NJËSIA PËR HETIMIN E ANKESAVE KUNDËR GJYQËSORIT**
- > **NJËSIA PËR HETIMIN E ANKESAVE KUNDËR PROKURORISË**
- > **NJËSIA PËR HETIMIN E ANKESAVE KUNDËR KËSHILLIT PROKURORIAL**
- > **NJËSIA PËR HETIMIN E ANKESAVE KUNDËR KËSHILLIT GJYQËSOR**
- > **NJËSIA PËR HETIMIN E ANKESAVE KUNDËR INSTITUTIT GJYQËSOR**

- Ky departament bashkëpunon me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, me donatorët dhe fondacionet vendore dhe ndërkombëtare, po ashtu me mediat vendore dhe ndërkombëtare, si dhe me institucionet relevante në fushën e integritimeve evropiane.

- Gjatë ditëve të hapura që realizohen nga IAP nëpër komunat e Kosovës zëvendësavokati Ibrahim Arslan mbulon komunat: Prizren, Suharekë, Dragash, Mamushë, Malishevë, Rahovec dhe Shtime.

Basri Berisha
ZËVENDËS I AVOKATIT TË POPULLIT



Shkollimi:

1991 Diplomoi në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës.

2010 Mbaroi studimet e magjistraturës në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës dhe ka marrë gradën shkencore Magjistër i shkencave juridike-administrative.

Ka marrë pjesë në një varg trajnime, seminare dhe konferenca për të drejtat e njeriut në Kosovë dhe jashtë saj.

Përvoja:

1996 - 1999 Hulumtues terreni dhe raportues për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, KMDLNJ.

1999 - 2006 Koordinator për informim dhe për trajnime në KMDLNJ.

1997 - 2006 Anëtar i përhershëm i redaksisë së Buletinit të KMDLNJ-së (botim periodik - për çdo tre muaj), ku ka botuar punime të ndryshme nga fusha e të drejtave të njeriut dhe shkrime për aktivitetet e KMDLNJ-së.

2006 - 2007 Anëtar i Kryesisë së KMDLNJ-së.

Ka ligjëruar për aspekte të ndryshme të të drejtave të njeriut në trajnime dhe seminare të ndryshme në Kosovë.

2006 - 2011 Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) - Zhvillues i Programit për Administratë të Përgjithshme.

2011 - Zëvendës i Avokatit të Popullit, udhëheqës në Departamentin e Legjislacionit.

DEPARTAMENTI I LEGJISLACIONIT

- > **NJËSIA PËR KOORDINIMIN E PUNËS LIDHUR ME KUVENDIN E KOSOVËS**
- > **NJËSIA PËR KOORDINIMIN E NGRITJES SË ÇËSHTJEVE NË GJYKATËN KUSHTETUESE**
- > **NJËSIA PËR VLERËSIMIN E PËRPUTHSHMËRISË SË LIGJEVE DHE AKTEVE NËNLIGJORE**
- > **NJËSIA PËR HETIMIN E ANKESAVE LIDHUR ME QASJEN NË DOKUMENTE PUBLIKE**
- > **NJËSIA PËR RAPORTIMIN VJETOR E PERIODIK**

- Ky departament bashkëpunon me komisionet parlamentare relevante (Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione; Komisioni për Legjislacion si dhe Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim.

- Gjatë ditëve të hapura që realizohen nga IAP nëpër komunat e Kosovës zëvendësavokati Basri Berisha mbulon komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Skënderaj, Drenas, Podujevë dhe Obiliq.

Jashar Kastrati
DREJTOR EKZEKUTIV



Shkollimi:

2002 diplomoi në Fakultetin Ekonomik, në Universitetin e Prishtinës

2010 përfundoi studimet postdiplomike, drejtimi i Menaxhmentit, në Universitetin e Prishtinës

Ka të kryera kurse të ndryshme dhe ka vijuar trajnime nga lëmi i financave, administratës dhe të sektorit të banimit.

Përvoja:

1992-1995 ka drejtuar biznesin privat në Ndërmarrjen për Shërbime Turistike “Teuta Tours” në Gjilan.

2002-2009 ka drejtuar sektorin e Banimit Social në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. Prej muajit shtator 2009 është në pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të Institucionit të Avokatit të Popullit.

- Drejtori Ekzekutiv është zyrtari kryesor administrativ në IAP i cili vepron në varësi të drejtpërdrejtë nga Avokati i Popullit dhe i përgjigjet atij për veprimtarinë e strukturave të institucionit.
- Drejtori Ekzekutiv kryen detyra për bashkërendimin e strukturave të institucionit dhe për zbatimin e politikave të miratuara në fushën e veprimtarisë së tij. Në përputhje me kërkesat e parashikuara me ligj dhe aktet tjera nënligjore si dhe me urdhrat apo detyrat e marra nga Avokati i Popullit, Drejtori Ekzekutiv siguron menaxhimin racional të burimeve njerëzore, të mjeteve financiare dhe burimeve materiale të institucionit.



Igballe Rrahmani

U.D E DETYRËS SË DREJTORIT TË
DEPARTAMENTIT TË HETIMEVE

Shkollimi:

1988 Diplomoi në Fakultetin Juridik në Prishtinë.

Ka marrë pjesë në shumë programe trajnimi lidhur me çështjet e mbrojtjes dhe ndihmës viktimave të krimit, barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut.

Përvoja:

2000 –2000 juriste në Shoqatën e juristeve për këshilla juridike “Norma”, në Prishtinë.

2001- 2001 Praktikante në Gjykatën Supreme të Kosovës.

2002 Zyrtare ligjore dhe për bibliotekë në Ministrinë e Shërbimeve Publike.

2002 –2003 Këshilltare për mbrojtjen e viktimave dhe për trajnime, Njësia për mbrojtje dhe ndihme viktimave, Departamenti i Drejtësisë

2003- 2007 Menaxhere e Mbrojtësve të Viktimave, Njësia për mbrojtje dhe ndihmë viktimave, Ministria e Drejtësisë.

2007- 2010 Jurist/hetues për të drejtat e fëmijëve, Institucioni i Avokatit të Popullit.

31. 12.2010 – 31.10.2011 U.d. së zëvendës drejtorit të Departamentit të Hetimeve.

Që nga 1 nëntori 2011 Ushtruese e detyrës së drejtorit të Departamentit të Hetimeve.

- Departamenti i hetimeve në kuadër të IAP merret me pranimin dhe shqyrtimin e ankesave, menaxhimin dhe koordinimin e punës lidhur me rastet.

Kontakti me Institucionin e Avokatit të Popullit e-mail adresa:

ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org
info@ombudspersonkosovo.org

Thirrjet falas për palët:

0800 15555

Adresa e Zyrës Qendrore:

Institucioni i Avokatit të Popullit

Lagjja Bregu i Diellit,

Rr. "Enver Maloku", nr. 28

10000 Prishtinë, KOSOVË

Puna me palë: e hënë – e premte, nga ora 08:00- 16:00

Tel: +381 (0) 38 223 782, +381 (0) 38 223 783,

+381 (0) 38 223 784 +381 (0) 38 223 789

Fax: +381 (0) 38 223 790

Zyra në Prizren

Adresa: Rr. "Remzi Ademi", pn

Tel: +381 (0) 29 222 138

Puna me palë: Të hënë dhe të
mërkurën, nga ora 10:00 - 14:00

Zyra në Pejë

Adresa: Rruga "Mbretëresha Teutë"

Nr.59, Kati III, Nr. 3, Ndërtesa e Komunës

Tel: +381 (0) 39 432 931

Puna me palë: Të hënë dhe të enjten,
nga ora 10:00 - 14:00

Zyra në Gjilan

Adresa: Rruga "Adem Jashari"

Ndërtesa e Komunës II

Tel: +381 (0) 280 320 843

Puna me palë: Të hënë dhe të enjten,
nga ora 10:00 - 14:00

Zyra në Mitrovicë

Adresa: Sheshi "Agim Hajrizi", pn,

Ndërtesa e Administ. Rajonale Tatimore

Tel: +381 (0) 28 530 138

Puna me palë: Të hënë dhe të enjten,
nga ora 10:00 - 14:00

Nën-zyra, Mitrovicë

Adresa: Rr. "Sami Frashëri" pa nr.

Lagja e Boshnjakëve,

Ndërtesa e ZAK në veri të Mitrovicës,

Tel: + 377 (0) 45 455 319 dhe

+381 (0) 64-956-00-50

Puna me palë: Të hënë dhe të enjten,
nga ora 10:00 - 14:00

Zyra në Graçanicë

Telefoni : +381 (0) 38 65 118

Tel. mobil: +377 (0) 44 367 719 dhe

+381 (0) 64 37 11 137

Puna me palë: Të hënë dhe të enjten,
nga ora 10:00 - 14:00